



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 06 Prot.

Tiranë 25/07/2023

Lënda: Vënie në dijeni mbi nisjen nga ana e Avokatit të Popullit të procesit për plotësim të vakancave për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga rradhët e Avokatëve dhe të Shoqërisë Civile

UNITED STATES DEPARTMENT OF JUSTICE, OPDAT
UNITED STATES EMBASSY, TIRANA, ALBANIA

Të nderuar,

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ju informojmë se më datë 19.07.2023 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka publikuar shpalljen e vendeve vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë dhe anëtarë zëvendësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe të shoqërisë civile.

Mbështetur në nenet 21-27 dhe 117-125 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Avokati i Popullit ka filluar punën për ndjekien dhe zbatimin e procedurave të mëtejshme administrative, për zhvillimin e procesit, në përputhje me kompetencat dhe afatet e caktuara në ligjin e sipërcituar.

Në kuadër të transparencës në kryerjen e këtij procesi, por nisur edhe nga ndihma e vyer që institucioni juaj ka dhënë dhe vazhdon të japë në kuadër të reformës në drejtësi, në rast se jeni të interesuar, ju ftojme të ndiqni procedurat administrative që do të zhvillohen nga institucioni ynë. Në rast të një përgjigje pozitive, javën e ardhshme do të zhvillojmë një takim informues për të diskutuar hapat e ndërmarra në kuadër të këtij procesi.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,
Sinqerisht,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

